



01 Nr. 335/25 Dt. 02.06.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr. 64257 datë 27.05.2025 së Shoqatës “Oldtimer Club”, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 64257 datë 27.05.2025 së Shoqatës “Oldtimer Club” nga Prizreni, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth organizimit (shënimit) të edicionit të 20 -të të “Oldtimer Fest Prizren 2025” që do të organizohet (mbahet) me datën 30, 31 maj dhe 1 qershor 2025, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve rreth këtij organizimi, lejohen mjetet financiare në shumën prej 500 € (pesëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shpenzime.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Shoqatës “Oldtimer Club”,
 - Arkivës së Kryetarit.